

VENDIM
Nr. 957, datë 29.12.2014

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK TE DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERITARE, TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË GODINËN NR. 57, NË BULEVARDIN “ZOGU I PARË”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 450, DATË 16.6.2005, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik te Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr. 15, nr. 16, nr. 17 dhe nr. 18, të godinës nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, Tiranë, sipas planimeve që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat aktualisht përdoren si mjedise pune nga Komisioni i Shërbimit Civil, për t’u dhënë në përdorim, pa pagesë, si mjedise pune, ish - presidentëve të Republikës së Shqipërisë.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 450, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.


3. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


000 61 9 8



ОУИИИ	ПАЛЛАТКА 37/1,2
ТИТУЛЪИ ЛЕТЪС	ПРОЦЕДУРА И КОНТ. ТЕРИТОР.
ПОМОЩНИ	ДИПЛОМАТИЯ И СЕРВИСЪИ ИМПЕРАТРИ
ОУИИИ	Н. Л. ПРОЦЕДУРА
СИМВОЛЪИ	77-888
СИМВОЛЪИ	К. 8888

0006498

PLANIMETRIA E KATIT TE PESTË Shkalla 1:100



Shkalla I

Sip. Ap. 5, 2+1 = 77.8 m² PRIVATIZUAR
 Sip. Ap. 6, 1+1 = 59.6 m²
 Sip. Korridor Shkalle = 28.2 m²
 Sip. Totale = 165.6 m²

Shkalla II

Sip. Ap. 17, 3+1 = 99.8 m²
 Sip. Ap. 18, 1+1 = 59.6 m²
 Sip. Korridor Shkalle = 28.2 m²
 Sip. Totale = 187.6 m²

OBJEKTI	PALLATI 57/1/2
TITULLI I PLANIT	PLANIMETRIA E KATIT TE PESTË
POZICIONET	DALLZORJA E BRESHMËT DIFLONATIK
GRUPTI I KËR	No. 17/1/2
GRUP. K. - GJENDORIT	17-18/2
Top. Ombra TONJA	K. 18/201
Top. Peshëb. ARKITEKT	

